



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 1400/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit V.S. B.I., me emër tregtar DPH “R...”, me numër unik identifikues ..., me seli në Suharekë, Qendra Zejtare, nr. 2, pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat B. B., me seli në Suharekë, Rr. “...”, kundër të paditurit Ministria së Tregtisë dhe Industrisë, për shkak të anulimit të vendimit nr. prot. 8439 të datës 27.11.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 13.03.2023, në prezencë të përfaqësuesit të paditësit, me datë 28.03.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit V.S. B.I. me emër tregtar DPH “R...” me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr. ref. 19, i datës 26.11.2018 (nr. prot. 8439 të datës 27.11.2018) i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi V...S...B.I., me emër tregtar DPH “R...”, përmes përfaqësuesit me autorizim ka parashtruar padinë me kërkesë për anulimin e vendimit 09 nr.351, të datës 03.10.2018 të nxjerrë nga Komuna e Suharekës, Drejtoria e Inspeksionit të Tregut, si jo i ligjshëm, me arsyetimin se aktvendimi i lartpërmendur me të cilin paditësi është urdhëruar të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë ekonomike – kafiteri është i kundërligjshëm, arbitrar, diskriminues dhe i pa bazë, pasi që paditësi posedon lejen e punës valide 04.nr.222/880 për llojin e biznesit - Kafiteri të cilën e ka lëshuar Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim. Po ashtu, aktvendimi i Drejtorisë së Inspeksionit përveç të metave materiale i cili nuk është i bazuar në asnjë dispozitë të së drejtës materiale në fuqi, është i kundërligjshëm, nuk respektohen aktet në fuqi të cilat rregullojnë fushë veprimtarinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike-kafiteri. Paditësi, përmes përfaqësuesit me autorizim me parashtrësën e datës 21.02.2021 ka bërë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv ashtu që në këtë çështje e paditur të jetë vetëm Ministria e Tregtisë dhe Industrisë po ashtu, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimin Nr.ref.19, i datës 26.11.2018

i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Inspektorati i Tregut, nr. prot. 8439 të datës 27.11.2018 me të cilin vendim mbetet në fuqi aktvendimi i datës 03.10.2018 i Drejtorisë së Inspeksionit të Tregut dhe urdhërohet paditësi V. V.S., pronar i biznesit DPH “R...” me seli në Suharekë të ndaloj ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-kafiteri. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datën 20.03.2023 ka qëndruar në tërësi pranë pretendimeve të paraqitura me shkrim dhe në seancën gjyqësore dhe ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor të aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

I padituri Ministria e Industrisë dhe Tregtisë me përgjigje në padi të datës 29.06.2021 e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se paditësi ushtron veprimtarinë –shërbime pijesh – kafiteri dhe i njëjti është njoftuar nga Inspektorët e Tregut – Komuna e Suharekës nëpërmjet vendimit 01.Nr.016-20279 të datës 26.04.2018 me të cilin vendim u ndalohej ushtrimi i veprimtarive lokale afariste që ushtronte veprimtari si kafiteritë, ëmbëltoret, klubet e natës, lojërat e fatit dhe lokalet që shërbejnë pije alkoolike e me këtë rast edhe pronarit të paditësit DPH “R...” z. V. S. i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë ekonomike- kafiteri. Tutje, ka theksuar se paditësi i pakënaqur me vendimin e Inspektorëve të Tregut – Komuna e Suharekës ka parashtruar ankesë drejtuar Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut MINT i cili me vendimin nr.19/6426 të datës 25.09.2018 e ka aprovuar pjesërisht ankesën e parashtruar dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe riformulim, përkatësisht aktvendimin 09.Nr.291 të datës 27.08.2018, të nxjerrë nga Inspektorët e Komunës së Suharekës. Gjithashtu ka shtuar se Inspektorati i Tregut në Komunën e Suharekës duke iu referuar vendimit të lartcekur ka nxjerr aktvendim 09.nr 351 me të cilin ka urdhëruar paditësin që të ndaloj ushtrimin e veprimtarisë së tij ekonomike-kafiteri. Ka shtuar se Inspektorati i Tregut-Mint ka nxjerr vendim me të cilin ka kthyer në rishqyrtim dhe riformulim të aktvendimin 09.Nr.291 të datës 27.08.2021 ndërsa sa u përket vendimeve dhe Rregulloreve të Kuvendit Komunal Inspektorati nuk ka kompetencë të ndërhyjë në këto vendime dhe konsiderohen se kanë qenë konform rregullave dhe procedurave ligjore. Në seancën e shqyrtimit kryesor i padituri nuk ka prezantuar andaj gjykata ka vazhduar shqyrtimin kryesor konform nenit 41 të LKA-së.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Aktvendim 02 nr.168 i datës 27.10.2010, leje Pune nr.222/880 e datës 22.12.2010, procesverbal mbi kryerjen e kontrollit inspektues dhe gjendjen e hasur i datës 07.02.2018, vendim i Kuvendit Komunal Suharekë nr.016/20279 i datës 29.04.2018, procesverbal mbi bastisjen e banesës dhe

personave të datës 27.04.2018, procesverbal mbi kryerjen e kontrollit inspektues dhe gjendjen e hasur i datës 02.08.2018, aktvendim 09 nr.291 i datës 27.08.2018, njoftim i Komunës së Suharekës për mbylljen e lokalit sipas vendimit nr.016-20279 i datës 16.04.2018, ankesë kundër vendimit 09 nr.291 e datës 03.09.2018, vendim nr.Ref 19 i datës 25.09.2018 i nxjerrë nga MTI, kërkesë për ekzekutim të vendimit i datës 28.09.2018, përgjigje në Kërkesë e datës 03.10.2018, aktvendim 09 nr.351 i datës 03.10.2018 ,ankesë e datës 09.10.2018, vendim nr.Ref 19 i datës 26.11.2018 i nxjerrë nga MTI, rekomandim i datës 06.04.2018 nga Këshilli Komunal për Sigurinë në Bashkësi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Gjykata konstatoi se me aktvendimin 09 Nr.291, të datës 27.08.2018, Drejtoria e Inspeksionit –Inspeksioni i Tregut ka urdhëruar paditësin V.V. S. –pronar i DPH “R...” në Suharekë, që të ndaloj ushtrimin e veprimtarisë ekonomike –kafiteri dhe në rast moszbatimi të urdhrorit do të merren masa ligjore si mbyllja e lokalit nga ana e Komunës dhe Policisë së Kosovës.

Paditësi i pa kënaqur me aktvendimin e Inspeksionit të Tregut, me datë 03.09.2018 ka parashtruar tek i padituri ankesë me nr. prot. 09. Nr.291, për shkak të shkeljes së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave të së drejtës procedurale dhe ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i Inspeksionit të Tregut 09 Nr.291, të datës 27.08.2018.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me vendimin 19 Nr.6424, të datës 25.09.2018, ka aprovuar pjesërisht ankesën e datës 03.09.2018, të parashtruar nga paditësi dhe aktvendimin 09 Nr.291, të datës 27.08.2018 i nxjerrë nga Inspektorët e Tregut të Komunës së Suharekës e ka kthyer në rishqyrtim dhe riformulim.

Tutje, Inspektorati i Tregut duke iu referuar vendimit nr.642 të datës 25.09.2018 ka marrë aktvendim me datën 03.10.2018, me nr. prot. 09 Nr.351 nëpërmjet të cilit e ka urdhëruar paditësin V.V. S. pronar i biznesit DPH “R...” që të ndaloj ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-kafiteri.

I pakënaqur me vendimin e lartcekur paditësi parashtron ankesë drejtuar Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datën 09.10.2018 për shkak të shkeljes së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave të së drejtës procedurale.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me vendimin kontestues të datës 27.11.2018, me nr. prot.8439 ka refuzuar ankesën e paditësit dhe lënë në fuqi aktvendimin 09.351 i datës 03.10.2018 i nxjerrë nga Inspektorët e Tregut të Komunës së Suharekës.

I pakënaqur me vendimin e të paditurit, paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 27 par. 4 të Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut i cili përcakton: “*Kundër aktvendimit të Kryeinspektorit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.*” dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: “*Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.*”

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga prova Vendim 01. Nr.016-20279 i datës 26.04.2018 i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, gjykata ka konstatuar se është ndaluar ushtrimi i veprimtarive të lokaleve afariste që ushtrojnë veprimtarinë: kafiteritë, ëmbëltoje, diskotekat, klubet e natës, lojërat e fatit, bastoret sportive dhe lokaleve tjera që shërbejnë pije alkoolike në Qendrën Zejtare Nr. 2 në Rr “...” në rr. “...” dhe në rr “...” konkretisht në brendësinë e trekëndëshit në Qendrën Zejtare 2.

Nga Prova Procesverbal mbi kryerjen e kontrollit inspektues dhe gjendjes së hasur i datës 02.08.2018, gjykata ka konstatuar se Inspektorati i Tregut në bazë të inspektimit të bërë ka përpiluar raportin me gjendjen e konstatuar gjatë kontrollit, ka konstatuar se “1. *Biznesi në fjalë ushtron veprimtarinë shërbime pijesh-kafiteri, provë certifikata e biznesit Nr.70698390. 2.Pronari i biznesit është njoftuar dhe iu ka dhënë një kopje e vendimit të Komunës së Suharekës 01.Nr.016-20279, Dt.26.04.2018 i cili vendim e ndalon ushtrimin e veprimtarisë afariste –shërbime pijesh (kafiteri), 3. Palës i është lënë një kopje nga biznesi, dhe krejt në*

fund të raportit është dhënë paralajmërimi që në afat prej 15 ditësh të zbatohet neni 1 i vendimit 01.Nr.016-20279 i datës 26.04.2018 i lëshuar nga Komuna e Suharekës.

Nga prova Procesverbal mbi bastisjen e banesës dhe personave e datës 27.04.2018 gjykata ka konstatuar se Drejtoria Rajonale e Policisë së Prizrenit ka bërë bastisjen e kafiterisë “R...” dhe ka konstatuar se gjatë kontrollit në prezencë të pronarit të lokalit nuk është gjetur asgjë joligjore.

Nga prova Kërkesë për ekzekutim të vendimit Nr. Ref.19 të datës 25.09.2018, gjykata ka konstatuar se paditësi ka kërkuar nga Komuna e Suharekës-Drejtoria e Inspeksionit që të ekzekutoj vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë , Inspektorati i Tregut nr. ref. 9 të datës 25.09.2018, përkatësisht të heq shiritat e vendosur rreth objektit DPH “R...”, ndërsa nga prova përgjigje në kërkesën e paditësit, lëshuar nga Inspektorati i Tregut të Komunës së Suharekës e datës 03.10.2018, 09.nr.349 ka pezulluar përkohësisht kërkesën duke sqaruar se lënda është në proces të rishqyrtimit dhe arsyetimit në mundësinë për vendosjen e çështjes nga një organ tjetër kompetent në këtë rast nga Inspeksioni i Tregut të MTI-së.

Nga prova Leje pune 04.Nr.222/880 e datës 22.12.2010, gjykata ka gjetur se paditësi DPH “R...” posedon lejen e punës valide, për llojin e biznesit kafiteri të cilën e ka lëshuar Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe e njëjta është veprimtari e ligjshme.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit me të cilin është ndaluar ushtrimi e veprimtarisë ekonomike - kafiteri DPH “R...”, për shkak se paditësi nuk ka vepruar në përputhje me vendimin e Kuvendit të Komunës së Suharekës me të cilin është ndaluar ushtrimi i veprimtarive të lokaleve afariste që ushtrojnë veprimtarinë: kafiteritë, ëmbëltore, diskotekat, klubet e natës, lojërat e fatit, bastoret sportive dhe lokaleve tjera që shërbejnë pije alkoolike në Qendrën Zejtare Nr.2 në rr. “...” në rr. “...” dhe në rr. “...” konkretisht në brendësinë e trekëndëshit në Qendrën Zejtare 2.

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se vendimi kontestues është nxjerrë në zbatim të Vendimit të Kuvendit Komunal Suharekë të miratuar në mbledhjen e datës 26.04.2018 duke u bazuar në nenin 12 par.2 pika c) të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe në Rekomandimi nr. 01-nr-016-15779 të datës 06.04.2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Neni 9 i Ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 5 par.3 të Ligjit nr. 04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.

03/L-181, përcakton se: “1. Inspektorati i tregut e kryen mbikëqyrjen inspektuese të zbatimit të ligjeve dhe akteve të tjera në lidhje me: 1.15. kushtet për të bërë biznes në përputhje me aktet nënligjore të veçanta.”

Në përputhje me këtë dispozitë ligjore si dhe me Vendimin e Kuvendit Komunal Suharekë të datës 26.04.2018, Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Suharekës ka nxjerrë vendimin 09 nr. 351 të datës 03.10.2018 me të cilin ka urdhëruar V.V. S. pronar i biznesit DPH “R...” që të ndaloj ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-kafiteri.

Gjithashtu gjykata vlerëson se duke qenë se vendimi 09 nr. 351 i datës 03.10.2018 është nxjerrë në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Suharekës dhe përderisa ky vendim i Kuvendit Komunal Suharekë mbetet në fuqi, ekziston baza ligjore e vendimeve kontestuese për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë që shërbejnë pije alkoolike në Qendrën Zejtare nr. 2 në Suharekë.

Lidhur me pretendimet e paditësit për kundërligjshmërinë e Vendimit të datës 26.04.2018 të Kuvendit Komunal Suharekë, gjykata vlerëson se në këtë procedurë nuk mund të vlerëson ligjshmërinë e të njëjtit pasi që konflikti administrativ në këtë çështje është iniciuar kundër vendimit nr. ref. 19 i datës 26.11.2018 (nr. prot. 8439, datë 27.11.2018) i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Prandaj, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur me vendimin e datës 27.11.2018, me nr. prot.8439 ka refuzuar ankesën e paditësit dhe lënë në fuqi aktvendimin 09 nr. 351 i datës 03.10.2018 i nxjerrë nga Inspektorët e Tregut të Komunës së Suharekës.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimin e të autorizuarit të paditësit të dhënë në padi se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e LPPA-së, por gjykata vlerëson se një pretendim i tillë nuk ka mbështetje ligjore pasi që përmbajtja e aktit kontestues është përpiluar në përputhje me nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcaktuar se: “1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për

mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.”

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.1400/22 datë 28.03.2023

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.